



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 459/4 prot.

Tiranë, më 11.05.2021

VENDIM

Nr.49, datë 11.05.2021

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT
TË KOMISIONERIT NR. 224, DATË 30.12.2020**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 224, datë 30.12.2020, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procedurës së konfirmimit si “nëpunës civil”, në përfundim të periudhës së provës për nëpunësin civil *****, dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes”*.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet kërkesës nr. 634 prot., datë 16.07.2020, nëpunësi ***** ka ngritur pretendimin për parregullsi të kryera ose të lejuara nga Bashkia Berat, për moszbatim të legjislacionit për shërbimin civil në lidhje me konfirmimin e nëpunësit civil në përfundim të periudhës së provës, duke kërkuar për këtë, ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për rregullimin e ligjshmërisë.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Bashkisë Berat të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 224, datë 30.12.2020 të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procedurës së konfirmimit si “nëpunës civil”, në përfundim të periudhës së provës për nëpunësin civil *****, dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Berat ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 224, datë 30.12.2020 si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë në institucionin e Bashkisë Berat paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse në Bashkinë Berat, që për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë, të veprojë sipas masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit nr. 224, datë 30.12.2020 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Konkretisht, Komisioneri ka kërkuar nga njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Berat, si organi kompetent për administrimin e shërbimit civil, të orientojë dhe ndjekë procesin e konfirmimit si nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës, për nëpunësin civil *****, gjithashtu Komisioneri ka kërkuar nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban, Monitorimit të Investimeve dhe Lejeve, në cilësinë e eprorit direkt, të nxjerrë aktin e njoftimit të njësisë përgjegjëse, në lidhje me përfundimin e periudhës së provës prej nëpunësit *****, përfundimin me sukses të trajnimit në ASPA dhe vlerësimin pozitiv të tij, në fund të periudhës së provës.

Konstatohet se, në zbatim të dispozitivit të vendimit nr. 224, datë 30.12.2020, Bashkia Berat me shkresën nr. 1952/1 prot., datë 16.04.2021, ka njoftuar Komisionerin se nga ana e institucionit janë marrë masa për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil me aktin nr. 69 prot., datë 07.01.21, Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban, Monitorimit të Investimeve dhe Lejeve, në cilësinë e eprorit direkt, ka nxjerrë aktin e konfirmimit si nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës për nëpunësin ***** bazuar në përcaktimet e nenit 24, pika 4, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 224, datë 30.12.2020, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procedurës së konfirmimit si “nëpunës civil”, në përfundim të periudhës së provës për nëpunësin civil *****, dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes ”.*
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Berat, duke zbatuar rekomandimet e vendimit nr.224, datë 30.12.2020.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Berat dhe nëpunësi *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA